

	<p align="center">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p align="center">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	<p align="center">PRISHTINA</p> 
---	---	--

Datë/a:	23.03.2021
Për/ Za/ To:	DWH – ALBANIA SHPK
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Aktivitetit të Prokurimit

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të datës 19.03.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik DWH – ALBANIA SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me instrument gjeodezik për nevojat e DIKMK dhe Drejtorisë për Pronë”, me Nr. të Prok: 616 21 015 111 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik DWH – ALBANIA SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me instrument gjeodezik për nevojat e DIKMK dhe Drejtorisë për Pronë”, me Nr. të Prok: 616 21 015 111, kundër Njoftimit për Kontratë të AK –së, të datës 15.03.2021 të publikuar në web-faqe të KRPP-së. të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me instrument gjeodezik për nevojat e DIKMK dhe Drejtorisë për Pronë”, me Nr. të Prok: 616 21 015 111.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 15.03.2021 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument gjeodezik për nevojat e DIKMK dhe Drejtorisë për Pronë", me Nr. të Prok: 616 21 015 111.

Me datë 19.03.2021, Operator Ekonomik: DWH – ALBANIA SHPK ka bërë kërkesë për rishqyrtim me c' rast ka kërkuar që tu ipen përgjigje në tri pyetjet e parashtruara si në vijim:

E nderuar AK,

ne jemi njohur me kerkesen tuaj per blerje te paisjeve gjeodezike ne tenderin me Nr.Pr. 616 21 015 111, dhe veme re, qe ju jeni duke aplikuar de jure "blerjen me tender" dhe de facto "blerjen nje burimore".

I - Specifikimet Teknike jane te bazuara ne menyre te kunderligjshme ne nje prodhues, Topcon-Sokkia, dhe pikerisht

- 1. Scanner eshte percaktuar ne serine GLS-2000*
- 2. Stacioni Total ne serine GL / iX e po ketij prodhuesi,*
- 3. GPS te Hipper / GRX3*
- 4. Nivelen ne serine DL, dhe*
- 5. Software ne Magnet*

lapidar jane specifikimet tuaja, qe vijojne:

- Skaner nr. i pikave 100.000 / seconde per ti hapur rrugen pseudoscanerit me 120.000 pika / sekonde te siperpermendur, kur scannerat punojne me 2 milion pika, pra 20x me shume; apo kerkesa per 50m rreze matjeje, kur te tjeret punojne me rreze 5-6 here me te madhe.

- GPS nuk ka asnje kerkese specifike, por "kalimthi" thuhet "te mase ne pjerresi", per te futur "gafil" nje GPS tuajin, qe nuk permbush kushtin themelore te matjes ne pjerresi, qe eshte "mosinfluenca e fushes magnetike".

- Kurse specifikat per software jane "manual ne vehte", asnje specifikim vetem "gjuhe kafeneje", qe jane "mure", qe mbrojne "deal-in" e nje ose me shume punonjesve te AK me OE e parazgjedhur.

Te gjitha keta karakteristika ne baze te LPP04/L-042, Neni 1, 2, 7 dh 28 duhen rishikuar, qe ti hapet rruga vehte LPP.

II - Gjuha e perdorur eshte nje gjuhe paushale, qe ka per qellim te largoje konkurrencen dhe ti hape rruge abuzimit ne vleresim.

Nuk mund te behet vleresim kur kerkesa behet me fjale te pergjigjthshme (tuajat), ne mungese te gjuhes teknike te datasheet-eve, pa parametra tte datasheet-eve, pra pa parametra sasiore dhe cilesor. Pyetja eshte si do te mund te behet vleresimi? Tenderi

eshte bere per te justifikuar blerjen, se "fustani eshte prere".

III - ju leshoheni ne kerkesa te cuditshme te papara dhe degjuara per garanci 5 vjecare!!!

1. Garancia 5 vjecare (nuk kuptohet perse nuk keni kerkuar 10, 20 vjecare ose te perhershme), ku nuk definohet se si duhet te

jete kjo garanci?! Pra ju kerkoni "carta bianca". Po ku e bazoni kete kerkese?

Por kushtet e garancise ne menyre eskuzive ne bote, jepen nga garantuesi. Eshte kjo e qarte per juve?

Vendi i gjyqit, ne rast mosmarrveshje, percaktohet po nga garantuesi. Eshte edhe kjo e qarte per juve?

2. Ju vazhdoni me kerkesat tuaja te habitshme, mirembajtje 5 vjecare?!!!

Mirembajtja fillon me mireperdorimin e produktit. Si mund te mbulohet mirembajtja nga liferuesi, kur e perdorni juve?

Mirembajtja mund te kerkoje pjese kembimi, te cilet kushtojne para. Po si mund te kalkulohen pjese, te cilat nuk dihen cilat

do jene, sa do jene dhe si rrjedhoje sa do kushtojne?

Po keshtu mirembajtja permban sherbim (manpower), oret e te cilit gjithashtu kushtojne para. Po si mund te kalkulohen ato

kur nuk dihet se sa do te jene?

3. Oreksi juaj ne kerkesa vazhdon dhe rritet me tej, support falas per 5 vjet sa, si dhe kur doni ju!!!!

Por OE jane subjekte biznesi dhe jo reparte ushtarake. Ku bazohen keto kerkesa? Ku e keni pare dhe degjuar ju kete kerkese?

4. Pastaj tejkaloni edhe vetveten, duke kerkuar edhe upgrade falas per 5 vjet!!!!

Upgrade eshte nje produkt, qe nuk eksiston ne momentin e liferimit. Dhe si mund te kalkulohet nje produkt kur ai akoma

nuk eshte prodhuar?

5. Ju kerkoni trainim 3 javor?

Kjo kerkese eshte akoma me e cuditshme, pasi ju kerkoni trainim te zgjatur edhe per produkt qe ju i dispononi prej vitesh dhe me te cilat presupozohet, qe kryeni pune? Por nese ju kerkoni trainim per produkte qe punoni, lind pyetja nese ju

punoni apo jo me ato?

Nese nuk eshte keshtu, pra nese ju i njihni dhe i perdorni, c'kuptim ka kjo kerkese? Juve kur ndrroni kerrin, beni autoskolle perseri dhe merrni patente te re?

Po kur ndrroni zyren, beni rishtas universitetin, ashtu , sic e keni, 3 vjecar?

IV - Kerkoni Software me fjale te pergjithshme, tuajat dhe kerkoni edhe dokumentacion (foto(!) thoni).

Kerkesat tuaja per SW jane delir i vertete. Po si mund te kerkoni SW me fjalet tuaja, po cfare eshte ky infantilitet ne vitin

2021?

E nderuar AK, kerkesat e ketij tenderi jane nje delir kolektiv - ky material ka kaluar ne

me shume se nje dore - por edhe nja katalog, par excellence, se si mund te shkelet ligji ne menyre te perseritur ne nje tender te vetem dhe ditën per diell.

Ne e dime, qe autori i ketyre kerkesave te AK, eshte vehte OE e perzgjedhur, pasi specifikimet teknike i kemi hasur identike edhe ne disa AK te tjera, por jemi te cuditur nga guximi i atyre qe brenda AK perqafojne kete praktike.

Ju nuk jeni ne gjendje te permbushni as Nenin 1, te LPP04/L-042, qe te hapni garen per sa me shume pjesmarres.

Ne vend te epilogut: Te ndjekesh nje agende personale ne kurriz te agendes se entit ku punon, pra me fjale te tjera te anashkalosh, apo te shkelesh ligjin per perfitime personale nuk eshte "JOB" i kujtdo. Kjo kerkon si parakusht, qe te jesh profesionalisht "on the top", ndryshe merresh vesh qe ne rreshtin e pare, si edhe eshte rasti juaj.

Kerkese:

Lutem rifromuloni dosjen e tenderit, duke e kthyer tenderin ne shtratin ligjor!

Baza Ligjore

Specifikimet teknike te vendosura në tender janë në përputhje të plotë me nevojat tona dhe janë specifika në përputhje të plotë me ligjin, pra janë specifika që i gjeni tek të gjithë prodhuesit më të njohur të paisjeve gjeodezike.

Ndoshta do të ishte e nderhme që OE të mos perdor gjuhë fyese për institucionin tonë deri në momentin që të merrte pergjigje zyrtare nga ana jonë për kërkesën për rishqyrtim. Megjithse përveç gjuhës ofenduese OE nuk kërkon gjë tjetër që përveç disa specifika të rriten dhe disa te ulen, pra bien ndesh me njëra tjetren.

Pretendimi numër 1. i OE.

I - Specifikimet Teknike janë të bazuara në menyrë të kundërligjshme në një prodhues:

Ky pretendim është i pavërtet, ashtu siq është e njohur nga të gjithë profesionistët, ekzistojn disa prodhues të njohur të instrumenteve gjeodezike që përdoren në gjeodezi, më të njohurit janë:

Trimble, Topcon, Leica etj. OE duhet të sjellë fakte konkrete të cilat dëshmojnë se ne jemi bazuar vetëm në një prodhues.

OE pretendon "...Skaner nr. i pikave 100.000 / second për të hapur rrugën pseudoscanerit me 120.000 pika / sekond të sipërpërmendur, kur scannerat punojnë me 2 milion pika, pra 20x më shumë; apo kërkesa për 50m rreze mateje, kur të tjerët punojnë me rreze 5-6 here më të madhe.."

OE është kontradiktor me vetëveten kur pretendon se kërkesat janë diskriminuese dhe akuzon institucionin tonë se kinse kemi vendosur specifika minimale!!

Bazuar në hulumtimin që AK i ka bërë tregut është ardhë në përfundim që numri minimal i pikave që skaneri kap për 1 sekond duhet të jetë minimalisht 100 000 dhe rrezja e matjes minimalisht 50m. Kjo specifik është vendosur që të siguroj garën e hapur për të gjithë prodhuesit.

Nëse ne do të ndjekim rekomandimin e OE ankues do të ishte në kundërshtimi me ligjin dhe do të favorizonim prodhues të caktuar.

OE pretendon: "GPS nuk ka asnjë kërkesë specifike por "kalimthi" thuhet "të masë në pjerrësi", për të futur "gafil" një GPS tuajin, që nuk permbush kushtin themelor të matjes në pjerrësi, që është "mosinfluenca e fushës magnetike"

AK ka specifikuar qartë kërkesat bazike që janë në përputhje me tregun dhe nevojat tona.

Siq dihet GPS është antenë, funksioni i së cilës është të marrë sinjale satelitore nga GPS, GLONASS, GALILEO dhe BEIDOU dhe të ofroj saktësinë që kërkohet për nevojat e gjeodezisë, krahas këtyre specifikave bazike ne kemi kërkuar edhe matjen në pjerrësi që është një inovacion që plotësohet nga të gjithë prodhuesit.

Pra, për neve si AK është e rëndësishme të ketë dhe këtë funksion dhe jo të fusim specifika të dyta në një kërkesë ku do të eliminonte shumë prodhues!

OE pretendon: "Kurse specifikat për software janë "manual në vehte", asnjë specifikim vetëm "gjuhë kafeneje", që janë "mure", që mbrojnë "deal-in" e një ose më shumë punonjësve të AK me OE e parazgjedhur."

Kërkesat për software-in janë shumë të qarta, këto kërkesa janë përpiluar bazuar në nevojat tona dhe nuk janë gjuhë kafeneje. OE duhet të ofroj fakte konkrete se ku është diskriminuar dhe jo të nënqmoj nevojat tona.

Lidhur me Garancionin

Garancioni që AK ka kërkuar është 3 vjet dhe jo 5 siq e potenconi! Është e drejt e plotë e AK-së që të kërkojë një garanci minimale duke pasur parasysh ndjeshmërinë e produkteve gjeodezike. Besojmë, që një garancion 3 vjeçar krahas 1 vjeçar standart, është në interesin e institucionit tonë dhe këtu nuk shohim diskriminim për asnjë prodhues!

Mirëmbajtja:

Besojmë që kërkesa për mirëmbajtjen e produkteve është e sqaruar shumë mirë!

Shkruhet: Mirëmbajtja dhe mbështetja duhet të jetë jo më pak se 5 vjetë, sa herë që AK-së të ketë nevojë për konsultime, trajnime shtesë (kjo duhet të përfshihet në Çmim), që në të ardhmen të mos ketë kosto shtesë!

Pra, AK nuk kërkon riparim të produkteve, por kërkon mirëmbajtje ku e potencon "Sa herë që AK të ketë nevojë për KONSULTIME, TRAJNIME SHTESE.

Është kërkuar Konsultim dhe Trajnim, dhe jo riparim siq e potenconi në ankesën tuaj. Sigurisht që në një blerje si kjo, stafi jonë do që të ketë siguri në investimet që bënë, dhe jo të bëhet një blerje dhe të mos perdoret. Dhe këtu nuk shohim diskriminim.

Konkluzion:

AK ka përcaktuar kërkesa të qarta të cilat janë në përputhje me nevojat tona dhe me tregun e hapur për të gjithë, nuk gjen as edhe një specifikim që është në kundërshtim me ligjin mbi prokurimin. OE ankohet në specifika duke thënë që të rriten specifikimet teknike dhe të ulët garancioni dhe mirëmbajtja, me fjalë tjera të hiqen nga gara prodhues tjerë dhe të ulët obligimi pas shitjes i OE fitues.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

